



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Komuna e Gjakovës
Opština Djakovica-Municipality of Gjakova

**RREGULLORE PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E
RREGULLORES NR.110/04-11191 MBI PLOTËSIMIN E KUSHTEVE
MINIMALE HIGJIENIKE, TEKNIKE DHE SANITARE PËR
LOKALET AFARISTE NË TERRITORIN E
KOMUNËS SË GJAKOVËS**

DRAFT

Mars 2022



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Komuna e Gjakovës
Opština Djakovica-Municipality of Gjakova

Kuvendi i Komunës, Gjakovë
Nr. _____
Datë XX.XX.2022

Kuvendi i Komunës së Gjakovës në bazë të nenit 12 (paragrafi 12.1 dhe 12.2., shkronja c) dhe nenit 40 (paragrafi 40.1 dhe 40.2 shkronja a) të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 18 (paragrafi 18.1 dhe 18.2 shkronja a) të Statutit të Komunës së Gjakovës, nenin 38 të Ligjit Nr.2004/18 për Tregtinë e Brendshme i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr.04/L-005 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.2004/18 për Tregtinë e Brendshme, nenin 2 (paragrafi 1, nen paragrafi 1.7) të Ligjit Nr.03/181 për Inspektoratin e Tregut, i Ndryshuar dhe Plotësuar me nenin 3 të Ligjit Nr.04/L-186 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut, në mbledhjen e mbajtur me datë XX.XX.2022, pas diskutimeve lidhur me pikën e X të rendit të ditës: shqyrtimi i draft Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr.110/04-11191 Mbi plotësimin e kushteve minimale higjienike, teknike dhe sanitare për lokalet afariste në Territorin e Komunës së Gjakovës, miratoj këtë:

**RREGULLORE PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E
RREGULLORES NR.110/04-11191 MBI PLOTËSIMIN E KUSHTEVE
MINIMALE HIGJIENIKE, TEKNIKE DHE SANITARE PËR
LOKALET AFARISTE NË TERRITORIN E
KOMUNËS SË GJAKOVËS**

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr.110/04-11191 Mbi Plotësimin e Kushteve Minimale Higjienike, Teknike dhe Sanitare për Lokalet Afariste në Territorin e Komunës së Gjakovës, (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Neni 2

Përkufizimet

Paragrafi 5 i nenit 3 të Rregullores bazike, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim:

5. Komisioni për pranim teknik: Inspektorët e Tregut.

Neni 3

Veprimtaritë tjera ekonomike

Paragrafi 2 i nenit 20 dhe 12 të Rregullores bazike, fshihet nga teksti i rregullores.

Neni 4

Procedura e ankesës kundër vendimit të inspektorit

Neni 27 i Rregullores bazike, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim:

1. Kundër vendimit të inspektorit të Tregut lejohet ankesa siç parashihet në ligjin në fuqi për Inspektoratin e Tregut.
2. Kundër vendimit të Inspektorit të Mbrojtjes së Mjedisit lejohet ankesa siç parashihet në ligjin për Inspektoratin e Mbrojtjes së Mjedisit.
3. Kundër vendimit të Inspektoratit Sanitar lejohet ankesa siç parashihet në ligjin në fuqi për Inspektoratin Sanitar.
4. Ankesa kundër vendimit të inspektorit i nxjerr sipas rregullores bazike dhe kësaj rregullore, nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të inspektorit, përveç në rastin e shqiptimit të gjobës.

Neni 5

Mbikëqyrja e zbatimit të kësaj rregullore

Paragrafi 1 i nenit 32 i Rregullores bazike, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim:

1. Mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj rregulloreje e bëjnë inspektorët e Tregut, Inspektorët Sanitar dhe Inspektorët e Mbrojtjes së Mjedisit.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjakovës dhe 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në uebfaqen e komunës së Gjakovës.

Arbënesha Kuqi

Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës